



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES IN FERIZAJ

Njësia Org. 1

Org. Unit

Nr. i faqeve 3

No. pages

Nr. Prot: 1643/24

Prot. No:

Data: 14.06.24

Data: 14.06.24

Datë: 14.06.2024

Në bazë të nenit 16, të Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe vendimit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), nr. 969/23, të datës 24.03.2023, Administrata Qendrore e UShAF, me datën 14.06.2024, shpallë:

KONKURS

PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE DHE TË DIPLOMUARVE NË PUNË PRAKTIKE NË ADMINISTRATËN QENDRORE TË UShAF.

I. Titulli i vendit të punës: Praktikantë, 5 (pesë) pozita në Administratën Qendrore të UShAF

- 2 (dy) studentë të diplomuar në UShAF në studimet baçelor ose master.
- 1 (një) student i rregullt (absolvent) në studimet baçelor në UShAF për laboratorët e Teknologjisë Informative në UShAF
- 1 (një) student i rregullt (absolvent) në studimet baçelor në UShAF për laboratorët e Inxhinierisë Industriale në UShAF
- 1 (një) student i rregullt (absolvent) në studimet baçelor në UShAF për laboratorët e Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobilieve në UShAF

1. Dy praktikantë në zyrën e shërbimit të studentëve;
2. Një praktikant në laboratorët e Teknologjisë Informative;
3. Një praktikant në laboratorët e Inxhinierisë Industriale;
4. Një praktikant në laboratorët e Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobilieve.

Periudha e angazhimit në punë praktike është për 6 (gjashtë) muaj me pagesë (200 euro bruto në muaj).

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të kenë përfunduar studimet baçelor ose master në UShAF (për pozitën nr.1);

- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë studentë aktual të rregullt në vitin e tretë (absolvent, të cilët kanë përfunduar ligjëratat e vitit të tretë) në studimet баçелор të UShAF, programi i studimit:

Informatikë e Aplikuar (për pozitën nr. 2);

Inxhinieri Industriale me Informatikë (për pozitën nr. 3);

Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve ose

Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri (për pozitën nr. 4)

- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, do të merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve e cila do të jetë përcaktuese në rangimin e kandidatëve. Në rast se dy kandidatë ose më shumë, të renditur të fundit në 5 (pesë) pozitat sipas notës mesatare, kanë notën mesatare të njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Nëse kandidatët janë të gjinisë së njëjtë (femërore) atëherë përzgjedhja do të bëhet me short në prezencë të kandidatëve.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Aplikacionin i cili merret në Administratën e UShAF, Zyra nr. 008;
- CV;
- Çertifikatën e lindjes (origjinale) ose ekstraktin e lindjes (origjinal);
- Çertifikatën e diplomës ose diplomën për kryerjen e studimeve баçелор ose master, origjinale apo të noterizuar (kandidatët që janë të diplomuar, të cilët konkurojnë për pozitën nr. 1).
- Çertifikatën e notave origjinale (studentët aktual-absolvent, të cilët konkurojnë për pozitën nr.2, nr.3 dhe nr. 4) ;
- Vërtetimin e statusit të studentit origjinal (studentët aktual-absolvent, të cilët konkurojnë për pozitën nr.2 nr.3 dhe nr. 4);

Aplikacionet e plotësuara së bashku me dokumentacionin e nevojshëm sipas konkursit, duhet të dorëzohen në formë fizike në zyrën nr. 008 dhe në adresën elektronike në e-mail: info@ushaf.net.

Konkursi mbetet i hapur tetë (8) ditë, përkatësisht nga data **14.06.2024** deri me datën **21.06.2024** në orën 16:00.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë në ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda tri ditëve.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë me konkurs nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur dhe jo të përzgjedhur nga komisioni profesional do të bëhet në Web faqen e Universitetit.

Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë (08:00-16:00) sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët të cilët nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 48 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në kuadër të UShAF.

Ferizaj, 14.06.2024

ADMINISTRATA QENDRORE E UShAF

